

UDHËZIM
Nr. 8 datë 28.3.2023

PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE PROCEDURAT E APLIKIMIT, MËNYRËS SË LLOGARITJES SË KOMPENSIMIT, VERIFIKIMIT DHE ANKIMIMIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe pikës 1, të kreut V, të VKM-së 114, datë 1.3.2023, “Përdorimin e fondit të kontingjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për çdo të punësuar më pagë minimale, për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi”,

UDHËZOJ:

I. MËNYRA DHE PROCEDURA E KËRKESËS

1. Subjektet private që kanë të drejtë të aplikojnë për të përfitur nga fondi i kontingjencës për kompensimin financiar janë subjekte juridike apo fizike që kanë të punësuar punëmarrës që paguhen me pagë minimale dhe ushtrojnë aktivitet në fushat e veprimtarisë ekonomike të industrisë përpunuese, peshkimit, bujqësisë dhe pyjeve, të cilat rezultojnë në regjistrin e tatimpaguesve të administratës tatimore, që u fillon kodin NACE2 me A dhe C.

2. Subjektet private, të cilat plotësojnë kriteret për kërkesën sipas pikës 4, kreu II, të VKM-së nr. 114 datë 1.3.2023, plotësojnë formularin e kërkesës elektronikisht nëpërmjet portalit *e-Albania*, në shërbimin “Kërkesë për kompensim financiar të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”.

a) Afati i kërkesës është jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës, nga muaji i pritshëm i deklarimit, për periudhën që kërkohet kompensim, në të kundërt e drejta e kompensimit për atë periudhë humbet. Formulari i kërkesës, sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi, përmban të dhëna identifikuese për subjektin dhe të dhëna që vërtetojnë se subjekti:

b) nuk është në pronësi shtetërore;

c) nuk është i vetëpunësuar;

d) nuk është në proces falimentimi;

ç) si dhe nuk ka detyrime ndaj organeve tatimore për sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore, deri në momentin e kërkesës ose në momentin e kërkesës të vërtetojnë, se:

i. kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;

ii. kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjokat.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjeneron nga sistemi i tatimeve listën e subjekteve private, të ndarë sipas çdo drejtorie rajonale tatimore, që plotësojnë kriteret sipas pikës 4/kreu II, të VKM-së nr. 114/2023, me të dhënat e muajit dhjetor 2022 dhe i dërgojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s.

4. Drejtoria e Përgjithshme e AKPA-s shpërndan listën si më sipër në drejtoritë rajonale të AKPA-s, së bashku me informacionin, si më poshtë:

a) NIPT;

b) emër subjekti;

c) statusi juridik (duke përjashtuar subjekte në pronësi shtetërore dhe të vetëpunësuarit);

ç) me statusin proces falimentimi;

d) fusha e veprimtarisë ekonomike (industri përpunuese, peshkim, bujqësi, pyje);

dh) numri i të punësuarve me pagë minimale;

e) të mos ketë detyrime tatimore për sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore, deri në momentin e kërkesës ose në momentin e kërkesës të vërtetojnë, se:

i. kanë lidhur marrëveshjet përkatëse për shlyerjen e këtyre detyrimeve dhe janë të rregullt në shlyerjen e tyre;

ii. kanë shlyer detyrimet, por kanë ende pa paguar gjokat;

ë) qarku dhe bashkia ku ka adresën primare subjekti.

5. Lista e subjekteve si më sipër gjenerohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe dërgohen pas datës 20 të çdo muaji, në Drejtorinë e Përgjithshme të Punësimit të AKPA-s.

II. VERIFIKIMI I KËRKESËS

1. Drejtoritë Rajonale të Punësimit, brenda 5 ditëve pune verifikojnë listën e subjekteve aplikuese me listën e gjeneruar nga sistemi tatimor.

2. Drejtoritë Rajonale të Punësimit informojnë nëpërmjet llogarisë në *e-Albania* dhe *email*, çdo subjekt kërkuar mbi statusin e kërkesës, refuzuar ose pranuar.

3. Për të gjitha kërkesat që plotësojnë kriteret, drejtoritë rajonale të punësimit, brenda 10 ditë pune, finalizojnë listën përfundimtare të subjekteve përfituese.

1. Lista e verifikuar e subjekteve përfituese përmban:

a) NIPT;

b) emrin e subjektit,

c) numrin e punonjësve me pagë minimale;

d) emrin e bankës së nivelit të dytë të subjektit;

e) IBAN të subjektit.

III. PROCEDURA E ANKIMIMIT

1. Aplikantët, kërkesa e të cilëve nuk është aprovuar ose pranuar pjesërisht, kanë të drejtën e ankimit pranë drejtorit të drejtorisë rajonale të AKPA-s, brenda 3 ditëve pune, nga momenti i publikimit të listës përfundimtare të subjekteve përfituese.

2. Drejtori i drejtorisë rajonale të AKPA-s shqyrton dhe merr vendim mbi ankimin e subjektit/subjekteve brenda 5 ditëve pune.

3. Vendimi i drejtorit të drejtorisë rajonale i njoftohet menjëherë subjektit ankimues, i cili ka të drejtë të kundërshtojë këtë vendim marrje në Drejtorinë e Përgjithshme të AKPA-s. Në rast moszgjidhjeje të ankimit në rrugë administrative, subjekti ankimues mund t'u drejtohet organeve të tjera kompetente.

IV. PROCEDURA DHE MËNYRA E LLOGARITJES SË KOMPENSIMIT E FINANCIMIT

1. Çdo drejtori rajonale e punësimit pas konfirmimit të listës përfundimtare të përfituesve, llogarit kompensimin në bazë të numrit të punonjësve me pagë minimale të subjektit aplikues, referuar edhe periudhës kontributive të muajit dhjetor 2022, sipas pikës 1/kreu II të VKM-së nr. 114/2023.

2. Shuma totale për çdo kompensim për çdo muaj do të bazohet në numrin e punonjësve, në masën 1,674 (një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë për çdo punonjës e llogaritur në referencë edhe të periudhës kontributive të muajit dhjetor 2022, sipas pikës 1/kreu II të VKM-së nr. 114/2023.

3. Drejtoritë rajonale të punësimit hartojnë dokumentacionin e nevojshëm për likuidim, në zbatim të legjislacionit financiar, dhe procedojnë në kalimin e fondeve në favor të subjekteve përfituese.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të dërgojë listën sipas pikës 1 të kreut II të VKM-së nr. 114/2023, brenda datës 10 prill 2023.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj